



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 1022 Prot

Tiranë, më 12/09 / 2023

NJOFTIM

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i RSH”, i ndryshuar; Ligjit nr. 90 dt.27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”; Vendimit nr 326, datë 31.05.2023 “*Pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa Institucione të Administratës Publike*”; Urdhrit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”; Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së; shpall 1 (një) vend vakant në pozicionin e punës:

Specialist në Sektorin e Promocionit dhe Imazhit pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Rreth Nesh:

Teatri Kombëtar i Operas Baletit dhe Ansamblit Popullor është një institucion kulturor i përkushtuar për të promovuar dhe fuqizuar akoma më tepër kulturën tonë artistike, të muzikës e kërcimit.

Me qëllim ndërtimin e një shoqërie me shtylla të forta kulturore, duke u angazhuar në krijimin e programeve që sjellin zhvillim të qëndrueshëm dhe punësim, duke huazuar nga përvojat më të suksesshme evropiane si dhe krijuar ura bashkëpunimi me partnerë të besueshëm dhe të qëndrueshëm brenda Republikës së Shqipërisë, rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe në Evropë, përmes gjuhës universale të muzikës.

Përgjatë 1 viti tashmë, TKOB ka rritur numrin e shfaqjeve, programeve, bashkëpunimeve e projekteve, duke ndikuar kështu edhe në rritjen e vizibilitetit deri në trefishim të shifrave.

Ne aktualisht po kërkojmë një Specialist të Talentuar të Marketingut për t’iu bashkuar ekipit tonë në promovimin e produksioneve tona të jashtëzakonshme.

Përmbledhja e Punës:

Specialisti i Marketingut ka një rol kyç në krijimin dhe zbatimin e strategjive të marketingut, për promovimin e produksioneve tona, të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor. Kjo për të angazhuar audiencën dhe maksimizuar shitjen e biletave, duke bashkëpunuar ngushtë me ekipin e marketingut, artistët dhe stafin e prodhimit.

Përgjegjësitë Kyçe:

Zhvillimi i Strategjisë së Marketingut: Zhvillon dhe ekzekuton plane të plota të marketingut për çdo produksion të operës, baletit dhe Ansamblit Popullor.

Marketingu Digjital: Menaxhon aktivitetin tonë në median online të TKOB-së, duke përfshirë përmbajtjen e WEB-it, llogaritë në mediat sociale, marketingun me email dhe koordinimin për dizajnin e posterave.

Krijimi i Përmbajtjes: Prodhoni materiale promovuese të cilësisë së lartë, duke përfshirë përshkrime për postime/ video/ foto dhe komunikata për media, për të përcjellë efektivisht thelbin e çdo produksioni dhe tërhequr interesin e përdoruesve potencialë.

Marrëdhëniet me Publikun: Koordinon marrëdhëniet me gazetarët për të siguruar mbulim mediatik të shfaqjeve dhe programeve të TKOB-së, si dhe përgatit njoftimet për shtyp. Gjithashtu punon ngushtë në punën me publikun fizik apo online, për të kanalizuar preferencat e tyre në marrjen e informacionit për shfaqjet teatrale.

Shitja e Biletave: Bashkëpunon me ekipin e biletarisë në proceset e shitjes së biletave.

Analizim dhe Raportim: I aftë në analizimin e statistikave për të ndjekur efikasitetin e fushatave të marketingut dhe për të dhënë ide në përmirësimin e marketingut.

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme dhe kërkesat e veçanta si më poshtë:

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta në Marketing, Gazetari, Komunikim ose fusha të ngjashme (preferohet Diplomë master);
2. Të jetë njohës/e shumë i/e mirë e drejtëshkrimit të gjuhës shqipe dhe njohës i gjuhës angleze;
3. Të ketë së paku 1 vit përvojë pune në marketing (preferohet në fushën e arteve);
4. Të zotërojë njohuri të mira të programeve specifike dizajnuese si Photoshop, Canva, Adobe Premiere Pro apo programe të tjera të ngjashme;
5. Të ketë aftësi për të ndërtuar dhe shkruar një histori/tekst nëpërmjet të dhënave;
6. Të ketë aftësi të mira në komunikim verbal dhe të shkruar si dhe të ketë punuar me afate të përcaktuara (deadline);
7. Të ketë aftësi sa I përket krijimit të përmbajtjeve të komunikimit (komunikatë për shtyp, artikuj, komunikim online, dhe material të tjera të lidhura me përmbajtjen);
8. Të jetë kreativ në ide dhe të njohë mirë zhanrin e muzikës dhe baletit.
9. Të njohë dhe të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike;
10. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi, si dhe të jetë i/e aftë për të punuar në grup;

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

1. Letër motivimi për pozicionin e punës së shpallur;
2. Jetëshkrimi CV;
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
4. Fotokopje e diplomës dhe e listës së notave të noterizuara;
5. Dokument për kualifikime, dëshmi trajnimesh të ndryshme, etj (nëse ka);
6. Fotokopje të librezës së punës;
7. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
8. Një numër telefoni si dhe adresa e plotë të vendbanimit.

*Dokumentat duhen të paraqiten në gjuhën shqipe.

Mosparaqitja e plotë dhe në kohë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit.

KONKURIMI: Është i hapur

Dokumentacioni do të dorëzohet pranë sekretarisë së TKOBAP(zyra e protokollit) ose të skanuara në e-mailin zyrtar të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri me datë 16.10.2023 me subjektin: Aplikim për Specialist Marketing-u. Pas verifikimit të dokumentave të kërkuara, në Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara, do të lajmërohen nëpërmjet numrit të tyre të kontaktit ose me e-mail nga Sekretaria e Institucionit për intervistën e strukturuar me gojë.

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, si dhe data kur do të shpallet fituesi, mund ti gjeni në faqen zyrtare të ëeb-it të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor www.tkob.gov.al; faqja zyrtare e Agjensisë së Prokurimit Publik www.app.gov.al.

DREJTORE e PËRGJITHSHME

Abigeila VOSHTINA

